

STANDARDI NDËRKOMBËTAR I AUDITIMIT 805 (I RISHIKUAR)

KONSIDERATA TË VEÇANTA—AUDITIMET E PASQYRAVE FINANCIARE TË VETME, ELEMENTËVE, LLOGARIVE OSE ZËRAVE TË VEÇANTË TË NJË PASQYRE FINANCIARE

(Ka hyrë në fuqi për auditimet për periudhat
që janë mbyllur më datën 15 Dhjetor 2016 ose pas kësaj date)

PËRMBAJTA

	Paragrafi
Hyrje	
Objekti i këtij SNA-je	1–3
Hyrja në Fuqi	4
Objektivi	5
Përkufizimet	6
Kërkesat	
Konsiderata Kur Pranohet Angazhimi	7–9
Konsiderata Gjatë Planifikimit dhe Kryerjes së Auditimit	10
Formimi i një Opinioni dhe Konsiderata për Raportimin	11–17
Zbatimi dhe Materiali Tjetër Shpjegues	
Objekti i këtij SNA-je	A1–A4
Konsiderata Kur Pranohet Angazhimi	A5–A9
Konsiderata Gjatë Planifikimit dhe Kryerjes së Auditimit	A10–A15
Formimi i një Opinioni dhe Konsiderata për Raportimin	A16–A28
Shtojcë 1: Shembuj të Elementëve, Llogarive ose Zërave të Veçantë të një Pasqyre Financiare	
Shtojcë 2: Ilustrime të Raportit të Audituesit të Pavarur mbi Pasqyrat Financiare të Vetme dhe mbi një Element të Veçantë të një Pasqyre Financiare.	

Standardi Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) 805 (i rishikuar), *Konsiderata të Veçanta—Auditimet e Pasqyrave Financiare të Vetme, Elementëve, Llogarive ose Zërave të Veçantë të një Pasqyre Financiare*, duhet të lexohet së bashku me SNA 200, *Objektivat e Përgjithshme të një Audituesi të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit*.

Hyrje

Objekti i këtij SNA-je

1. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) seria nga 100 –700 zbatohen për një auditim të pasqyrave financiare dhe do të përshtaten sipas nevojës, në rrethanat kur ato zbatohen për auditimet e informacioneve të tjera historike financiare. Ky SNA trajton konsiderata të veçanta në zbatimin e këtyre SNA-ve në auditimin e një pasqyre financiare të vetme, ose elementëve, llogarive ose të zërave të veçantë të një pasqyre financiare. Një pasqyrë financiare e vetme, ose elementi, llogaria apo zëri i veçantë i një pasqyre financiare mund të përgatitet në përputhje me një kuadër për qëllime të përgjithshme ose për qëllime të veçanta. Nëse është përgatitur në përputhje me një kuadër për qëllime të veçanta, përsëri për auditimin do të zbatohet SNA 800 (i rishikuar)¹. (Ref: Para. A1–A4)
2. Ky standard nuk zbatohet për raportin e audituesit të një komponenti (entiteti të kontrolluar), të lëshuar si rezultat i punës së bërë mbi informacionin financiar të një komponenti, me kërkesë të grupit të angazhimit të grupit të entiteteve të kontrolluara për qëllime të një auditimi të pasqyrave financiare të grupit (të entiteteve të kontrolluara - për qartësim). (shih SNA 600).²
3. Ky SNA nuk i tejkalon kërkesat e SNA-ve të tjera; dhe as nuk ka për qëllim të merret me të gjithë konsideratat e veçanta, të cilat mund të jenë të rëndësishme në rrethanat e angazhimit.

Hyrja në fuqi

4. Ky SNA ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare të vetme ose të elementëve, llogarive apo zërave të veçantë, për periudhat që kanë filluar në ose pas datës 15 Dhjetor 2016. Në rastin e auditimeve të pasqyrave financiare të vetme ose të elementëve, llogarive apo zërave të veçantë të një pasqyre financiare në një datë të caktuar, ky SNA ka hyrë në fuqi për auditimet e këtyre informacioneve më datën 15 Dhjetor 2016 ose pas kësaj date.

Objektivi

5. Objektivi i audituesit kur zbaton SNA-të në një auditim të një pasqyre financiare të vetme ose të një elementi, llogarie apo zëri të veçantë të një

¹ SNA 800 (i rishikuar), *Konsiderata të Veçanta —Auditimi i Pasqyrave Financiare të Përgatitura në Përputhje me Kuadrot për Qëllime të Veçanta*.

² SNA 600, *Konsiderata të Veçanta—Auditimi i Paqyrave Financiare të Grupit (Përfshirë Punën e Audituesit të Entitetit të Kontrolluar)*

pasqyre financiare, është të adresojë në mënyrën e duhur konsideratat e veçanta që janë të përshtatshme për:

- (a) Pranimin e angazhimit;
- (b) Planifikimin dhe kryerjen e këtij angazhimi; dhe
- (c) Formimin e një opinioni dhe raportimin mbi pasqyrën financiare të vetme ose elementin, llogarinë apo zërin e veçantë të një pasqyre financiare.

Përkufizimet

6. Për qëllime të këtij SNA-je, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- (a) “Element i një pasqyre financiare” ose “elementi” ka kuptimin një “element, llogari, ose zë i pasqyrave financiare;”
- (b) “Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar” kanë kuptimin Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-të) të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit; dhe
- (c) Një pasqyrë financiare e vetme ose një element i veçantë i një pasqyre financiare, përfshin informacionet shpjeguese. Informacionet shpjeguese zakonisht përmbajnë informacione shpjeguese ose informacione të tjera përshkruese, të cilat lidhen me pasqyrën financiare ose elementin. (Ref: Para. A2)

Kërkesat

Konsiderata Kur Pranohet Angazhimi

Zbatimi i SNA-ve

7. SNA 200 kërkon që audituesi të respektojë të gjitha SNA-të që kanë të bëjnë me auditimin.³ Në rastin e auditimit të një pasqyre financiare të vetme ose të një elementi të veçantë të një pasqyre financiare, kjo kërkesë zbatohet pavarësisht nëse audituesi është i angazhuar edhe për të audituar paketën e plotë të pasqyrave financiare të entitetit. Nëse audituesi nuk është i angazhuar në auditimin e paketës së plotë të pasqyrave financiare të entitetit, audituesi do të përcaktojë nëse auditimi i një pasqyre financiare të vetme ose i një elementi të veçantë të këtyre pasqyrave financiare është i mundur të bëhet në përputhje me SNA-të. (Ref: Para. A5–A6)

³ SNA 200, *Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit*, paragrafi 18

Pranueshmëria e Kuadrit të Raportimit Financiar

8. SNA 210 kërkon që audituesi të përcaktojë nëse kuadri i raportimit financiar që do të zbatohet në përgatitjen e pasqyrave financiare është i pranueshëm.⁴ Në rastin e auditimit të një pasqyre financiare të vetme ose të një elementi të veçantë të një pasqyre financiare, kjo do të përfshijë përcaktimin nëse zbatimi i kuadrit të raportimit financiar do të rezultojë në një paraqitje që jep informacionet e duhura shpjeguese, për t'u mundësuar përdoruesve të synuar të kuptojnë informacionin që përmban pasqyra financiare ose elementi, dhe efektin e transaksioneve materiale dhe ngjarjeve në informacionin e dhënë në pasqyrat financiare ose elementin. (Ref: Para. A7)

Formimi i Opinioneve

9. SNA 210 kërkon që kushtet e pranuar të angazhimit të auditimit të përfshijnë formën e parashikuar të çdo raporti që do të lëshohet nga audituesi.⁵ Në rastin e auditimit të një pasqyre financiare të vetme ose të një elementi të veçantë të një pasqyre financiare, audituesi do të marrë parasysh nëse forma e parashikuar e opinionit është e përshtatshme për rrethanat. (Ref: Para. A8–A9)

Konsiderata Gjatë Planifikimit dhe Kryerjes së Auditimit

10. SNA 200 deklaron që SNA-të janë hartuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare; ato duhet të përshtaten sipas nevojës në rrethanat kur zbatohen në auditimet e informacioneve të tjera financiare historike.^{6,7} Kur planifikon dhe kryen auditimin e një pasqyre financiare të vetme ose të një elementi të veçantë të një pasqyre financiare, audituesi do të përshtasë të gjitha SNA-të që lidhen me auditimin sipas nevojës në rrethanat e angazhimit. (Ref: Para. A10–A15)

Formimi i një Opinioni dhe Konsiderata për Raportimin

11. Kur formon opinionin dhe raportin mbi një pasqyrë financiare të vetme ose mbi një element të veçantë të një pasqyre financiare, audituesi do të zbatojë kërkesat e SNA 700 (i rishikuar),⁸ dhe, kur është e zbatueshme, SNA 800 (i

⁴ SNA 210, *Rënia Dakord me Kushtet e Angazhimit*, paragrafi 6(a)

⁵ SNA 210, paragrafi 10(e)

⁶ SNA 200, paragrafi 2

⁷ SNA 200, paragrafi 13(f), shpjegon që termi “pasqyrë financiare” zakonisht i referohet një pakete të plotë të pasqyrave financiare siç përcaktohet nga kërkesat e kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar.

⁸ SNA 700 (i rishikuar), *Formimi i një Opinioni dhe Raportimi mbi Pasqyrat Financiare*

rishikuar), të përshtatura sipas nevojës në rrethanat e angazhimit. (Ref: Para. A16–A22)

Raportimi mbi Paketën e Plotë të Pasqyrave Financiare të Entitetit dhe mbi një Pasqyrë të Vetme Financiare ose mbi një Element të Veçantë të Këtyre Pasqyrave Financiare.

12. Nëse audituesi merr përsipër një angazhim për të raportuar mbi një pasqyrë financiare të vetme ose mbi një element të veçantë të pasqyrave financiare, në lidhje me një angazhim për të audituar paketën e plotë të pasqyrave financiare të entitetit, ai për secilin angazhim do të shprehë një opinion të veçantë.
13. Pasqyra financiare e vetme e audituar ose elementi i veçantë i audituar i një pasqyre financiare mund të publikohen së bashku me paketën e plotë të pasqyrave financiare të audituara të entitetit. Nëse audituesi arrin në përfundimin që paraqitja e një pasqyre financiare të vetme ose elementi të veçantë të pasqyrave financiare, nuk e diferencon atë mjaftueshëm nga auditimi i paketës së plotë të pasqyrave financiare, audituesi do t'i kërkojë drejtimin të rregullojë situatën. Në varësi të paragrafeve 15 dhe 16, audituesi gjithashtu, do të diferencojë opinionin mbi pasqyrën e vetme financiare ose mbi elementin e veçantë të një pasqyre financiare, nga opinion mbi paketën e plotë të pasqyrave financiare. Audituesi nuk do të lëshojë raportin e audituesit të pavarur që përmban opinionin mbi pasqyrën financiare të vetme ose mbi një element të veçantë të një pasqyre financiare, derisa ai të bindet për diferencimin.

Marrja në Konsideratë e Ndikimit të Disa Çështjeve të Përfshira në Raportin e Audituesit të Pavarur mbi Paketën e Plotë të Pasqyrave Financiare të Entitetit për Auditimin e një Pasqyre Financiare të Vetme ose të një Elementi të Veçantë të një Pasqyre të Vetme Financiare dhe për Raportin e Audituesit mbi Ato.

14. Nëse raporti i audituesit mbi paketën e plotë të pasqyrave financiare të entitetit përfshin:
 - (a) Një opinion të modifikuar, në përputhje me SNA 705 (i rishikuar);⁹
 - (b) Një paragraf që thekson një çështje ose një paragraf për çështje të tjera në përputhje me SNA 706 (i rishikuar);¹⁰
 - (c) Një seksion të pasigurisë materiale që lidhet me vijimësinë, në përputhje me SNA 570 (i rishikuar);¹¹

⁹ SNA 705 (i rishikuar), *Modifikimet e Opinionit në Raportin e Audituesit të Pavarur*

¹⁰ SNA 706 (i rishikuar), *Paragrafi që Thekson Çështjen dhe Paragrafë të Tjera në Raportin e Audituesit të Pavarur*

¹¹ SNA 570 (i rishikuar), *Vijimësia*, paragrafi 22

- (d) Komunikimin e çështjeve kryesore të auditimit, në përputhje me SNA 701;¹² ose
- (e) Një deklaratë që përshkruan një anomali materiale të pakorrigjuar të informacionit tjetër, në përputhje me SNA 720 (i rishikuar);¹³

audituesi do të marrë në konsideratë ndikimet, nëse ka, që këto çështje kanë për auditimin e një pasqyre financiare të vetme ose të një elementi të veçantë të një pasqyre financiare dhe për raportin e audituesit mbi ato. (Ref: Para. A23–A27)

Opinion Kundër ose Refuzim i Opinioneve në Raportin e Audituesit të Pavarur mbi Paketën e Plotë të Pasqyrave Financiare të Entitetit

- 15. Nëse audituesi arrin në përfundimin se duhet të shprehë një opinion kundër ose të refuzojë opinionin mbi paketën e plotë të pasqyrave financiare të entitetit në tërësi, SNA 705 (i rishikuar) nuk lejon që audituesi të përfshijë në të njëjtin raport të audituesit të pavarur, një opinion të pamodifikuar mbi një pasqyrë financiare të vetme, e cila është pjesë e këtyre pasqyrave financiare, ose mbi një element të veçantë të këtyre pasqyrave financiare.¹⁴ Kjo sepse një opinion i tillë, i pamodifikuar do të ishte në kundërshtim me opinionin kundër ose refuzimin e dhënies së opinionit mbi paketën e plotë të pasqyrave financiare të entitetit në tërësi. (Ref: Para. A28)
- 16. Nëse audituesi arrin në përfundimin se duhet të shprehë një opinion kundër ose të refuzojë opinionin mbi paketën e plotë të pasqyrave financiare të entitetit në tërësi, por në kontekstin e një auditimi të veçantë të elementit specifik të këtyre pasqyrave financiare, audituesi e konsideron gjithsesi, të përshtatshme të shprehë një opinion të pamodifikuar mbi atë element, audituesi do ta bëjë këtë vetëm nëse:
 - (a) Audituesi nuk ndalohej nga ligji ose rregullat për të vepruar në këtë mënyrë;
 - (b) Ky opinion është shprehur në raportin e audituesit, i cili nuk është publikuar së bashku me raportin e audituesit që përmban opinionin kundër ose që refuzon opinionin; dhe
 - (c) Elementi nuk përbën një pjesë të madhe të paketës së plotë të pasqyrave financiare të entitetit në tërësi.

¹² SNA 701, (i rishikuar), *Komunikimi i Çështjeve Kryesore të Auditimit në Raportin e Audituesit të Pavarur*, paragrafi 13

¹³ SNA 720 (i rishikuar), *Përgjegjësitë e Audituesit në Lidhje me Informacionet e Tjera*, paragrafi 22(e)(ii)

¹⁴ SNA 705 (i rishikuar), paragrafi 15

17. Audituesi nuk do të shprehë një opinion të pamodifikuar mbi një pasqyrë financiare të vetme ose mbi paketën e plotë të pasqyrave financiare, nëse audituesi ka shprehur një opinion kundër ose ka refuzuar opinionin për paketën e plotë të pasqyrave financiare në tërësi. E njëjta gjë vlen edhe nëse raporti i audituesit për një pasqyrë financiare të vetme nuk publikohet së bashku me raportin e audituesit që përmban opinionin kundër ose refuzimin e opinionit. Kjo për arsye se një pasqyrë financiare e vetme konsiderohet se përbën një pjesë të rëndësishme të këtyre pasqyrave financiare.

Aplikimi dhe Materiali Tjetër Shpjegues

Qëllimi i këtij SNA*je (Ref: Para. 1, 6(c))

- A1. SNA 200 përkufizon termin “informacion financiar historik” si informacion i shprehur në terma financiare në lidhje me një entitet të veçantë, i nxjerrë kryesisht nga sistemi kontabël i entitetit, për ngjarjet ekonomike të ndodhura në periudhat e kaluara ose për kushtet apo rrethanat ekonomike në momentet kohore në të kaluarën.¹⁵
- A2. SNA 200 përkufizon termin “pasqyra financiare” si një paraqitje e strukturuar e informacionit financiar historik, përfshirë informacionet shpjeguese, të cilat synojnë të komunikojnë burimet ekonomike ose detyrimet e një entiteti në një moment kohe të caktuar apo ndryshimet e ndodhura në to gjatë një periudhe kohe në pajtim me një kuadër të caktuar të raportimit financiar. Termi “pasqyra financiare” zakonisht i referohet një pakete të plotë të pasqyrave financiare siç përcaktohet nga kërkesat e kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar, por gjithashtu, mund t’i referohet edhe një pasqyre financiare të vetme. Informacionet shpjeguese përfshijnë informacionin shpjegues ose përshkrues, të shpallur siç kërkohet, shprehimisht i lejuar ose përndryshe, i lejuar nga kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar, për t’u paraqitur në pasqyrat financiare, ose në shënimet apo i trupëzuar në to me referim të kryqëzuar.¹⁶ Siç u përmend në paragrafin 6(c), referimi tek një pasqyrë financiare e vetme ose element i veçantë të pasqyrave financiare, përfshin informacionet përkatëse shpjeguese.

¹⁵ SNA 200, paragrafi 13(g)

¹⁶ SNA 200, paragrafi 13(f)

- A3 SNA-të janë shkruar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare;¹⁷ ato do të përshtaten sipas nevojës në rrethanat kur zbatohen në auditimin e informacioneve të tjera historike financiare, të tilla si një pasqyrë financiare e vetme ose një element i veçantë i pasqyrave financiare. Ky SNA ndihmon në këtë drejtim. (Shtojca 1 rendit shembuj të informacioneve financiare.
- A4. Një angazhim i sigurisë së arsyeshme, që ndryshon nga auditimi i informacioneve financiare historike, kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Angazhimeve të Sigurisë (SNAS) 3000 (i rishikuar).¹⁸

Konsiderata Kur Pranohet Angazhimi

Zbatimi i SNA-ve (Ref: Para. 7)

- A5. SNA 200 kërkon që audituesi të veprojë në pajtim me (a) kërkesat përkatëse etike, përfshirë ato që kanë të bëjnë me pavarësinë, në lidhje me angazhimet e auditimit të pasqyrave financiare, dhe (b) të gjitha SNA-të që lidhen me auditimin. Audituesit i kërkohet gjithashtu, të jetë në pajtim me çdo kërkesë të një SNA-je përveç nëse, në rrethanat e auditimit, i gjithë SNA nuk është i përshtatshëm ose kërkesa nuk është e përshtatshme, pasi ajo është e kushtëzuar dhe kushti nuk ekziston. Në rrethana përjashtimore, audituesi mund të gjykojë të nevojshme që të devijojë nga një kërkesë e zbatueshme e një SNA-je, duke kryer procedurat alternative të auditimit për të arritur qëllimin e kësaj kërkesë.¹⁹
- A6. Pajtueshmëria me kërkesat e SNA-ve që lidhen me auditimin e një pasqyre financiare të vetme ose të një elementi të veçantë të një pasqyre financiare, mund të mos jetë e mundur kur audituesi nuk është i angazhuar në auditimin e paketës së plotë të pasqyrave financiare të entitetit. Në raste të tilla audituesi nuk ka të njëjtin kuptim për entitetin dhe mjedisin e tij, përfshirë kontrollin e brendshëm, siç do të ishte nëse ai do të ishte audituesi i cili auditon gjithashtu paketën e plotë të pasqyrave financiare të entitetit. Gjithashtu, audituesi mund të mos ketë evidencë auditimi për cilësinë e përgjithshme të regjistrimeve kontabël ose të informacioneve të tjera kontabël që duhej të siguroheshin në një auditim të paketës së plotë të pasqyrave financiare të entitetit. Për rrjedhojë, audituesit mund t'i nevojitet evidencë e mëtejshme për të vërtetuar evidencën e auditimit të marrë nga regjistrimet në kontabilitet. Në rastin e auditimit të elementit të veçantë të një pasqyre financiare, SNA të caktuara kërkojnë punë auditimi që mund të jetë në shpërpjestim me elementin që auditohet. Për shembull, megjithëse

¹⁷ SNA 200, paragrafi 2

¹⁸ SNAS 3000 (i rishikuar), *Angazhimet e Sigurisë të Ndryshme nga Auditimet ose Rishikimet e Informacionit Financiar Historik*

¹⁹ SNA 200, paragrafet 14, 18, dhe 22–23

kërkesat e SNA 570 (i rishikuar) ka të ngjarë të jenë të përshtatshme, në rrethanat e një auditimi të një liste (tabele) të llogarive të arkëtueshme, pajtueshmëria me këto kërkesa mund të mos jetë e mundur për shkak të përpjekjeve të kërkuara të auditimit. Nëse audituesi arrin në përfundimin që auditimi i pasqyre financiare të vetme ose i një zëri të veçantë të një pasqyre financiare në përputhje me SNA-të mund të mos jetë i mundur, audituesi mund të diskutojë me drejtimin faktin nëse do të ishte më i mundshëm një lloj tjetër angazhimi.

Pranueshmëria e Kuadrit të Raportimit Financiar (Ref: Para. 8)

A7. Një pasqyrë financiare e vetme ose një element i veçantë i një pasqyre financiare mund të jetë përgatitur në përputhje me një kuadër të zbatueshëm të raportimit financiar, i cili bazohet në një kuadër të raportimit financiar të vendosur nga një organizatë e autorizuar ose e njohur e hartimit të standardeve për përgatitjen e një pakete të plotë të pasqyrave financiare (për shembull, SNRF-të). Nëse është ky rast, përcaktimi i pranueshmërisë së kuadrit të zbatueshëm mund të përfshijë vlerësimin nëse ky kuadër përfshin të gjitha kërkesat e kuadrit në të cilin ai është bazuar dhe që janë të përshtatshme për paraqitjen e një pasqyre financiare të vetme ose të një elementi të veçantë të një pasqyre financiare, të cilat përfshijnë shënimet shpjeguese.

Forma e Opinionit (Ref: Para. 9)

A8. Forma e opinionit që duhet të shprehë audituesi varet nga kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar dhe ndonjë ligj apo rregull i zbatueshëm.²⁰ Në përputhje me SNA 700 (i rishikuar):²¹

- (a) Kur shpreh një opinion të pamodifikuar mbi një paketë të plotë të pasqyrave financiare të përgatitura në përputhje me një kuadër të paraqitjes së drejtë, opinionin e audituesit përveç nëse kërkohet ndryshe me ligj ose rregullore, përdor një nga frazat e mëposhtme:
 - (i) pasqyrat financiare paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me [kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar]; ose
 - (ii) pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë në përputhje me [kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar]; dhe
- (b) Kur shpreh një opinion të pamodifikuar mbi një paketë të plotë të pasqyrave financiare të përgatitura në përputhje me një kuadër të

²⁰ SNA 200, paragrafi 8

²¹ SNA 700 (i rishikuar), paragrafet 25–26

pajtueshmërisë, opinionit i audituesit shprehet se pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me [kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar].

A9. Në rastin e një pasqyre financiare të vetme ose të një elementi të veçantë të një pasqyre financiare, kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar mund të mos adresojë në mënyrë të shprehur qartë paraqitjen e pasqyrës financiare ose të elementit të veçantë të pasqyrës financiare. Ky mund të jetë rasti, kur kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar bazohet në një kuadër të raportimit financiar të hartuar nga një organizatë e autorizuar ose e njohur për hartimin e standardeve për përgatitjen e një pakete të plotë të pasqyrave financiare (p.sh. SNRF-të). Prandaj, audituesi vlerëson nëse forma e opinionit të shprehur është e përshtatshme në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar. Faktorët që mund të ndikojnë në vlerësimin e audituesit për faktin nëse përdorimi, në opinionin e audituesit, i shprehjeve “paraqet drejt në të gjitha aspektet materiale” ose “jep një pamje të vërtetë dhe të drejtë”, përfshijnë:

- Faktin nëse kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar është qartësisht ose plotësisht i kufizuar në përgatitjen e një pakete të plotë të pasqyrave financiare.
- Faktin nëse pasqyra financiare e vetme ose elementi i veçantë i një pasqyre financiare:
 - Do të jenë plotësisht në pajtim me secilën nga kërkesat e kuadrit të duhur, në veçanti për pasqyrën financiare ose elementin e veçantë, dhe paraqitja e pasqyrës financiare ose elementit të veçantë të një pasqyre financiare përfshijnë shënimet shpjeguese përkatëse.
 - Kur është nevoja për të arritur paraqitjen e drejtë, do të japin informacionet shpjeguese përtej atyre që specifikisht kërkohen nga kuadri ose, në rrethana përjashtimore, devijojnë nga një kërkesë e kuadrit.

Vendimi i audituesit për formën e opinionit të pritsëm është një çështje e gjykimit profesional. Ai mund të ndikohet nga fakti nëse përdorimi i frazave “paraqet drejt, në të gjitha aspektet materiale”, ose “jep një pamje të vërtetë dhe të drejtë” në opinionin e audituesit mbi një pasqyrë financiare të vetme ose mbi një element të veçantë të një pasqyre financiare të përgatitur në përputhje me një kuadër të paraqitjes së drejtë, është pranuar gjerësisht në juridiksionin e veçantë.

Konsiderata Gjatë Planifikimit dhe Kryerjes së Auditimit (Ref: Para. 10)

- A10. Zbatueshmëria e secilës nga SNA-të kërkon gjykim të kujdesshëm. Edhe kur kryhet auditimi vetëm për një element të veçantë të një pasqyre financiare, SNA-të të tilla si, SNA 240,²² SNA 550²³ dhe SNA 570 (i rishikuar), në parim do të zbatohen. Kjo për faktin se elementi mund të jetë i keqparaqitur si rezultat i mashtrimit, efekt i transaksioneve me palët e lidhura, ose zbatim i gabuar i bazës kontabël të vijimësisë sipas kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar.
- A11. SNA 260 (i rishikuar) kërkon që audituesi të përcaktojë personin(at) e përshtatshëm brenda strukturës qeverisëse të entitetit, me të cilët ai duhet të komunikojë.²⁴ SNA 260 (i rishikuar) vëren se, në disa raste, të gjithë ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë të përfshirë në drejtimin e entitetit dhe, zbatim i kërkesave të komunikimit modifikohet nisur nga ky fakt.²⁵ Kur entiteti ka përgatitur edhe një paketë të plotë të pasqyrave financiare, personat përgjegjës për mbikqyrjen e përgatitjes së një pasqyre financiare të vetme ose të një elementi mund të mos jenë të njëjtë me personat e ngarkuar me qeverisjen, që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e përgatitjes së paketës së plotë të pasqyrave financiare.
- A12. Për më tepër, SNA-të janë shkruar në kontekstin e një auditimi të pasqyrave financiare; ato duhet të përshtaten sipas nevojës, në rrethanat kur aplikohen për auditimin e një pasqyre financiare të vetme²⁶ ose të një elementi të veçantë të një pasqyre financiare. Për shembull, deklaratimet me shkrim të drejtimit për paketën e plotë të pasqyrave financiare mund të zëvendësohen me deklaratimet me shkrim për pasqyrën financiare ose elementin në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.
- A13. Çështjet e përfshira në raportin e audituesit mbi paketën e plotë të pasqyrave financiare mund të kenë ndikim në auditimin e një pasqyre financiare të vetme ose një elementi të një pasqyre financiare. (shih paragrafin 14). Kur planifikohet dhe kryhet një auditim i një pasqyre financiare të vetme ose një elementi të veçantë të një pasqyre financiare i lidhur me auditimin e paketës së plotë të pasqyrave financiare të entitetit, audituesi mund të jetë në gjendje të përdorë evidencën e auditimit të siguar si pjesë e auditimit të paketës së plotë të pasqyrave financiare të entitetit në auditimin e pasqyrës financiare të vetme ose të elementit. SNA-

²² SNA 240, *Përgjegjësitë e Audituesit Lidhur me Mashtrimin në një Auditim të Pasqyrave Financiare*

²³ SNA 550, *Palët e Lidhura*

²⁴ SNA 260 (i rishikuar), *Komunikimi me Personat e Ngarkuar me Qeverisjen*, paragrafi 11

²⁵ SNA 260 (i rishikuar), paragrafi 10(b), 13, A1 (pika e tretë), A2 dhe A8.

²⁶ SNA 200, paragrafi 2

të, megjithatë, kërkojnë që audituesi të planifikojë dhe kryejë auditimin e pasqyrës financiare ose të elementit për të siguruar evidencën e auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme mbi të cilën të bazojë opinionin mbi pasqyrën financiare ose elementin.

- A14. Pasqyrat financiare individuale që përfshijnë një paketë të plotë të pasqyrave financiare dhe, shumë elementë të veçantë të këtyre pasqyrave financiare, përfshirë dhe shënimet shpjeguese, janë të ndërlidhura. Prandaj gjatë auditimit të një pasqyre financiare të vetme ose një elementi të veçantë të një pasqyre financiare, audituesi mund të mos jetë në gjendje të vlerësojë pasqyrën financiare ose elementin në izolim. Për pasojë, për të përbushur objektivin e auditimit, audituesit mund t'i nevojitet të kryejë procedura në lidhje me çështjet e ndërlidhura.
- A15. Për më tepër, materialiteti i përcaktuar për një pasqyrë financiare të vetme ose për një element të veçantë të një pasqyre financiare, mund të jetë më i ulët se materialiteti i përcaktuar për paketën e plotë të pasqyrave financiare të entitetit; kjo do të ndikojë natyrën, afatet dhe shtrirjen e procedurave të auditimit dhe vlerësimin e anomalive të pakorrigjuara.

Formimi i një Opinioni dhe Konsiderata për Raportimin (Ref: Para. 11)

- A16. SNA 700 (i rishikuar) kërkon që, për formimin e një opinioni, audituesi të vlerësojë nëse pasqyrat financiare kanë informacione shpjeguese të përshtatshme, që ju mundësojnë përdoruesve të synuar të kuptojnë efektet e transaksioneve materiale dhe ngjarjeve në informacionin e përfshirë në pasqyrat financiare.²⁷ Në rastin e një pasqyre financiare të vetme ose të një elementi të veçantë të një pasqyre financiare, është e rëndësishme që pasqyra financiare ose elementi, duke patur parasysh kërkesat e kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar, të kenë informacione shpjeguese të përshtatshme për t'ju mundësuar përdoruesve të synuar të kuptojnë informacionin e përfshirë në pasqyrën financiare ose elementin, dhe efektin e transaksioneve materiale dhe ngjarjeve në informacionin e përfshirë në pasqyrën financiare ose elementin.

²⁷ SNA 700 (i rishikuar), paragrafi 13(e)

A17. Shtojca 2 përmban ilustrime të raportit të audituesit të pavarur mbi një pasqyrë financiare të vetme dhe mbi një element të veçantë të një pasqyre financiare. Ilustrime të tjera të raportit të audituesit mund të jenë të përshtatshme për raportimin mbi një pasqyrë financiare të vetme ose mbi një element të veçantë të një pasqyre financiare (shiko, për shembull, Shtojcat në SNA 700 (i rishikuar), SNA 705 (i rishikuar), SNA 570 (i rishikuar), SNA 720 (i rishikuar), dhe SNA 706 (i rishikuar)).

Zbatimi i SNA 700 (i rishikuar) Kur Raportohet mbi një Pasqyrë Financiarë të Vetme ose mbi një Element të Veçantë të një Pasqyre Financiare

A18. Paragrafi 11 i këtij SNA-je shpjegon se audituesi është i detyruar të zbatojë kërkesat e SNA 700 (i rishikuar), të përshtatura sipas nevojës në rrethanat e angazhimit, kur formohet një opinion dhe raportohet mbi një pasqyrë financiare të vetme ose mbi një element të veçantë të një pasqyre financiare. Kur vepron kështu, audituesi kërkohet gjithashtu, të zbatojë kërkesat e raportimit në SNA-të e tjera, të përshtatura sipas nevojës në rrethanat e angazhimit, dhe mund t'i gjejë të dobishme konsideratat e adresuara në paragrafët A19–A21 më poshtë.

Vijimësia

A19. Në varësi të kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar të përdorur në përgatitjen e një pasqyre financiare të vetme ose të një elementi të veçantë të një pasqyre financiare, përshkrimi, në raportin e audituesit, i përgjegjësive të drejtimit²⁸ lidhur me vijimësinë mund të ketë nevojë të përshtatet sipas nevojës. Përshkrimi në raportin e audituesit i përgjegjësive të audituesit²⁹ gjithashtu, mund të përshtatet sipas nevojës në varësi të mënyrës sesi SNA 570 (i rishikuar) zbatohet në rrethanat e angazhimit.

Çështjet Kryesore të Auditimit

A20. SNA 700 (i rishikuar) kërkon që audituesi të komunikojë çështjet kryesore të auditimit në përputhje me SNA 701 për auditimet e paketave të plota të pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme, të entiteteve të listuara.³⁰ Për auditimin e një pasqyre financiare të vetme ose të një elementi të veçantë të një pasqyre financiare, SNA 701 zbatohet vetëm kur komunikimi i çështjeve kryesore të auditimit në raportin e audituesit për pasqyrat financiare ose elementët është i kërkuar nga ligji ose rregullat, ose përndryshe, kur audituesi vendos vetë të komunikojë çështjet kryesore të auditimit. Kur çështjet kryesore të auditimit janë komunikuar në raportin e audituesit për një pasqyrë financiare ose një element të veçantë të një

²⁸ Shiko SNA 700 (i rishikuar), paragrafet 34(b) dhe A48.

²⁹ Shiko SNA 700 (i rishikuar), paragrafet 39(b)(iv).

³⁰ SNA 700 (i rishikuar), paragrafi 30

pasqyre financiare, SNA 701 zbatohet në tërësinë e tij.³¹

Informacione të Tjera

A21. SNA 720 (i rishikuar) trajton përgjegjësitë e audituesit në lidhje me informacionet e tjera. Në kontekstin e këtij SNA-je, raportet që përmbajnë ose shoqërojnë pasqyrën financiare të vetme ose elementin e veçantë të një pasqyre financiare - qëllimi i të cilës është të sigurojë për pronarët (ose palët e ngjashme të interesit) informacione mbi çështjet e paraqitura në pasqyrën financiare të vetme ose në elementin e veçantë të një pasqyre financiare — të cilat për qëllime të SNA 720 (i rishikuar) janë konsideruar raporte vjetore. Kur audituesi vlerëson se entiteti planifikon të nxjerrë një raport të tillë, për auditimin e pasqyrës së vetme financiare ose të elementit, do të zbatohen kërkesat e SNA 720 (i rishikuar).

Emri i Partnerit (Ortakut) të Angazhimit

A22. Kërkesa në SNA 700 (i rishikuar) që audituesi të përfshijë emrin e partnerit të angazhimit në raportin e audituesit zbatohet gjithashtu, në auditimet e një pasqyre financiare të vetme të entiteteve të listuara ose të elementëve të veçantë të pasqyrave financiare të entiteteve të listuara.³² Audituesit mund t'i kërkohej nga ligji ose rregullat, që të përfshijë emrin e partnerit të angazhimit në raportin e audituesit ose mund të vendosë ta bëjë këtë kur raportin mbi një pasqyrë financiare të vetme ose mbi një element të veçantë të një pasqyre financiare të vetme të entiteteve të tjera, të ndryshme nga entitetet e listuara.

Raportimi mbi Paketën e Plotë të Pasqyrave Financiare të Entitetit dhe mbi një Pasqyrë Financiare të Vetme ose mbi një Element të Veçantë të Pasqyrës Financiare (Ref: Para. 14)

Vlerësimi i pasojave të disa çështjeve të përfshira në raportin e audituesit mbi paketën e plotë të pasqyrave financiare të entitetit për auditimin e pasqyrës financiare të vetme ose të elementit të veçantë të një pasqyre financiare dhe për raportin e audituesit mbi këto pasqyra.

A23. Paragrafi 14 kërkon që audituesi të vlerësojë pasojat, nëse ka, të disa çështjeve të përfshira në raportin e audituesit mbi paketën e plotë të pasqyrave financiare për auditimin e një pasqyre financiare të vetme ose të një elementi të veçantë të një pasqyre financiare dhe për raportin e audituesit mbi to. Vlerësimi se kur një çështje e përfshirë në raportin e audituesit mbi një paketë të plotë të pasqyrave financiare është e përshtatshme në kontekstin e një angazhimi për të raportuar mbi një pasqyrë

³¹ SNA 700 (i rishikuar), paragrafi 31

³² Shiko SNA 700 (i rishikuar), paragrafet 46 dhe A61–A63.

financiare të vetme ose një element të veçantë të një pasqyre financiare, përfshin gjykimin profesional.

A24. Faktorët që mund të jenë të përshtatshëm kur vlerësohen këto pasoja, përfshijnë:

- Natyrën e çështjes(ve) të trajtuara në raportin e audituesit mbi paketën e plotë të pasqyrave financiare dhe shkallën në të cilën ajo lidhet me atë që përfshihet në pasqyrën financiare të vetme ose në elementin e veçantë të një pasqyre financiare.
- Shkallën e përhapjes së çështjes(ve) të trajtuara në raportin e audituesit mbi paketën e plotë të pasqyrave financiare.
- Natyrën dhe shtrirjen e ndryshimeve midis kuadrove të zbatueshëm të raportimit financiar.
- Shkalla e diferencës midis periudhës(ve) të mbuluara nga paketa e plotë e pasqyrave financiare në krahasim me periudhën(at) ose datat e një pasqyre financiare të vetme ose të një elementi të një pasqyre financiare.
- Koha që ka kaluar nga data e raportit të audituesit mbi paketën e plotë të pasqyrave financiare.

A25. Për shembull, në rastet kur, në raportin e audituesit mbi paketën e plotë të pasqyrave financiare, ka një rezervë në opinionin e audituesit në lidhje me llogaritë e arkëtueshme, dhe pasqyra financiare e vetme përfshin llogaritë e arkëtueshme, ose elementi i veçantë i një pasqyre financiare lidhet me llogaritë e arkëtueshme, ka të ngjarë të ketë ndikime në auditim. Nga ana tjetër, nëse rezerva në opinionin e audituesit mbi paketën e plotë të pasqyrave financiare ka të bëjë me klasifikimin e detyrimeve afatgjata, atëherë ka më pak të ngjarë që nga kjo të ketë ndikim në auditimin e një pasqyre financiare të vetme siç është pasqyra e të ardhurave, ose nëse elementi i veçantë i pasqyrave financiare lidhet me llogaritë e arkëtueshme.

A26. Çështjet kryesore të auditimit që komunikohen në raportin e audituesit mbi paketën e plotë të pasqyrave financiare mund të kenë ndikime në auditimin e një pasqyre financiare të vetme ose të një elementi të veçantë të një pasqyre financiare. Informacioni i përfshirë në seksionin e Çështjeve Kryesore të Auditimit për mënyrën sesi çështja ka qenë adresuar në auditimin e paketës së plotë të pasqyrave financiare mund të jetë i dobishëm për përcaktimin nga audituesi të mënyrës së adresimit të çështjes kur ajo është e përshtatshme për auditimin e pasqyrës financiare të vetme ose të elementit të veçantë të pasqyrës financiare.

Përfshirja e një Referimi në Raportin e Audituesit mbi Paketën e Plotë të Pasqyrave Financiare

A27. Edhe kur disa çështje të paraqitura në raportin e audituesit mbi paketën e plotë të pasqyrave financiare nuk kanë ndikime për auditimin ose për raportin e audituesit mbi pasqyrën financiare të vetme ose elementin e veçantë të pasqyrës financiare, audituesi mund të shikojë të përshtatshme t'i referohet çështjes(ve) në një paragraf për Çështje të Tjera në raportin e audituesit për një pasqyrë financiare të vetme ose për një element të veçantë të një pasqyre financiare (shiko SNA 706 (i rishikuar)).³³ Për shembull, në raportin e audituesit mbi një pasqyrë financiare të vetme ose mbi një element të veçantë të një pasqyre financiare, audituesi mund të vlerësojë si të përshtatshme t'i referohet seksionit të pasigurisë materiale që lidhet me vijimësinë, të përfshirë në raportin e audituesit mbi paketën e plotë të pasqyrave financiare.

Opinion Kundër ose Refuzim i Opinionit në Raportin e Audituesit për Paketën e Plotë të Pasqyrave Financiare të Entitetit (Ref: Para. 15)

A28. Në raportin e audituesit mbi paketën e plotë të pasqyrave financiare të një entiteti, shprehja e një refuzimi të opinionit lidhur me rezultatet e operacioneve të entitetit dhe flukseve të parasë, kur është e përshtatshme dhe e një opinionit të pamodifikuar lidhur me pozicionin financiar, është i lejuar meqenëse refuzimi i opinionit lidhet vetëm me rezultatet e operacioneve dhe flukset e parasë dhe jo me pasqyrat financiare në tërësi.³⁴

³³ Shiko SNA 706 (i rishikuar), paragrafet 10–11.

³⁴ SNA 510, *Angazhimet Fillestare të Auditimit—Tepricat e Çeljes*, Paragrafi A8, dhe SNA 705 (i rishikuar), paragrafi A16

Shtojcë 1

(Ref: Para. A3)

Shembuj të Elementëve, Llogarive, ose Zërave të Veçantë të një Pasqyre Financiare

- Llogaritë e arkëtueshme, provizionet për llogari të arkëtueshme të dyshimta, inventarët, detyrimi për përfitimet e llogaritura të një skeme private të pensioneve, vlera e regjistruar e aktiveve jomateriale të identifikuar, ose detyrimi për pretendimet “e ndodhura por jo të regjistruara” në një portofol të sigurimeve, përfshirë shënimet shpjeguese.
- Një tabelë e aktiveve të menaxhuara nga jashtë (nga të tretë) dhe të ardhurat e një skeme private të pensioneve, përfshirë shënimet shpjeguese.
- Një tabelë e aktiveve materiale neto, përfshirë shënimet shpjeguese.
- Një tabelë e pagesave në lidhje me një aktiv të dhënë me qira, përfshirë shënimet shpjeguese.
- Një tabelë e pjesëmarrjes në fitim ose e shpërblimit të punonjësve, përfshirë shënimet shpjeguese.

Shtojcë 2

(Ref: Para. A17)

Ilustrime të Raportit të Audituesit të Pavarur mbi një Pasqyrë Financiare të Vetme dhe mbi një Element të Veçantë të një Pasqyre Financiare

- Ilustrimi 1: Një raport i audituesit mbi një pasqyrë financiare të vetme të një entiteti të ndryshëm nga një entitet i listuar, i përgatitur në përputhje me një kuadër për qëllime të përgjithshme (për qëllime të këtij ilustrimi, një kuadër i paraqitjes së drejtë).
- Ilustrimi 2: Një raport i audituesit mbi një pasqyrë financiare të një entiteti të ndryshëm nga një entitet i listuar, i përgatitur në përputhje me një kuadër për qëllime të veçanta (për qëllime të këtij ilustrimi, një kuadër i paraqitjes së drejtë).
- Ilustrimi 3: Një raport i audituesit mbi një element të veçantë të një pasqyre financiare të një entiteti të listuar, i përgatitur në përputhje me një kuadër për qëllime të veçanta (për qëllime të këtij ilustrimi, një kuadër i pajtueshmërisë).

Ilustrimi 1: Një raport i audituesit mbi një pasqyrë financiare të një entiteti që nuk është një entitet i listuar, i përgatitur në përputhje me një kuadër për qëllime të përgjithshme (për qëllime të këtij ilustrimi një kuadër i paraqitjes së drejtë).

Për qëllime të këtij raporti ilustrues të audituesit, supozohen se ekzistojnë rrethanat e mëposhtme:

- Auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar (pra një pasqyrë financiare e vetme) të një entiteti që nuk është një entitet i listuar.
- Pasqyra e pozicionit financiar është përgatitur nga drejtimi i entitetit në përputhje me kërkesat e Kuadrit të Raportimit Financiar në Juridiksionin X që lidhet me përgatitjen e një bilanci.
- Kushtet e angazhimit të auditimit reflektojnë përshkrimin e përgjegjësive të drejtimit për pasqyrat financiare, sipas SNA 210.
- Kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar është një kuadër i paraqitjes së drejtë, i hartuar për të plotësuar nevojat e zakonshme për informacion financiar të një game të gjerë përdoruesish.
- Audituesi ka përcaktuar se, është e përshtatshme që në opinionin e audituesit, të përdoret shprehja “paraqet drejt, në të gjitha aspektet materiale”.
- Kërkesat përkatëse etike që zbatohen për auditimin janë ato të juridiksionit.
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguar, audituesi ka arritur në përfundimin se ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimarinë në pajtim me SNA 570 (i rishikuar). Informacionet shpjeguese të pasigurisë materiale në një pasqyrë financiare të vetme, janë të mjaftueshme.
- Audituesit nuk i kërkohet, dhe ai përndryshe, nuk ka vendosur të komunikojë çështjet kryesore të auditimit në pajtim me SNA 701 në kontekstin e auditimit të bilancit.
- Audituesi ka vlerësuar se nuk ka informacione të tjera (d.m.th., kërkesat e SNA 720 (i rishikuar) nuk zbatohen).
- Personat përgjegjës për mbikëqyrjen e pasqyrave financiare ndryshojnë nga ata që janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare.

Audituesi nuk ka përgjegjësi të tjera për të raportuar, të kërkuara nga legjislacioni ose rregullat lokale.

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

[Marrësi i Përshtatshëm]

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë tregtare ABC (Shoqëria), më datën 31 Dhjetor, 20X1 dhe shënimet e pasqyrës financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme (së bashku me “pasqyrën financiare”).

Sipas opinionit tonë, pasqyra financiare bashkëlidhur paraqet drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 Dhjetor 20X1 në përputhje me ato kërkesa të Kuadrit të Raportimit Financiar në Juridiksionin X që lidhen me përgatitjen e kësaj pasqyre financiare. [Seksioni i Opinionit është vendosur në fillim siç kërkohet nga SNA 700 (i rishikuar)]

Baza për Ppinionin

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrës financiare në [juridiksionin], dhe kemi përbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. [Fjalitë e para dhe të fundit në këtë seksion më parë kanë qënë në Seksionin e Përgjegjësisë së Audituesit. Gjithashtu, seksioni Baza për Opinionin është vendosur menjëhere pas seksionit të Opinionit siç kërkohet nga SNA 700 (i rishikuar).]

Pasiguria Materiale Lidhur me Vijimësinë

Ne tërheqim vëmendjen për Shënimin 6 të pasqyrës financiare, e cila tregon se Shoqëria pësoi një humbje neto prej ZZZ, gjatë vitit që u mbyll më datën 31 Dhjetor, 20X1 dhe, në këtë datë, detyrimet aktuale të Shoqërisë tejkaluan totalin e asetëve të saj për shumën YYY. Siç shprehet në Shënimin 6, këto ngjarje ose kushte, së bashku me çështje të tjera të përcaktuara në Shënimin 6, tregojnë se ekziston një pasiguri materiale e cila mund të hedhë dyshime të mëdha në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin në vijimësi. Në lidhje me këtë çështje, nuk është modifikuar opinionit.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrën Financiare³⁵

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrës

³⁵ Ne të gjitha këto raporte të audituesit, ilustruese, termat drejtimi dhe personat e ngarkuar me qeverisjen mund të ketë nevojë të zëvendësohen me një term tjetër që është i përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor në juridiksionin e veçantë.

financiare në përputhje me kërkesat e Kuadrit të Raportimit Financiar të Juridiksionit X që lidhet me përgatitjen e kësaj pasqyre financiare, dhe për ato kontrole të brendshme, që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e një pasqyre financiare që nuk përmban anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrës financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin në vijimësi, duke dhënë informacione, kur kjo është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe përdorimin e bazës kontabël të vijimësisë përveç nëse, drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet e saj, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë sigurinë e arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve, gjithnjë do të identifikojë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, ato pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra mbi bazën e kësaj pasqyre financiare.

Paragrafi 41(b) i SNA 700 (i rishikuar) shpjegon se materiali i hijëzuar më poshtë mund të vendoset në një Shtojcë të Raportit të Audituesit. Paragrafi 41(c) i SNA 700 (i rishikuar) shpjegon se referimi mund të bëhet në faqen e internetit të një autoriteti të përshtatshëm, i cili përmban përgjegjësitë e audituesit, kur ligji, rregullat ose standardet kombëtare të auditimit e lejojnë shprehimisht, në vend të përfshirjes së këtij materiali në raportin e audituesit, duke u siguruar që përshkrimi në faqen e internetit trajton, dhe nuk është në kundërshtim me përshkrimin e përgjegjësive të audituesit si më poshtë.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjthashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrës financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe sigurojmë evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të patur një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se rreziku që rrjedh nga gabimi, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara ose anashkalime të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë një njohje dhe kuptim të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me

auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.³⁶

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të bëra, nëse ka të tilla, dhe të informacioneve shpjeguese përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit nga drejtimi të bazës kontabël të vijimësisë të përdorur dhe, bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar veprimtarinë në vijimësi. Nëse ne arrijmë në përfundimin se ka një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit, për informacionet shpjeguese të dhëna në pasqyrën financiare, ose në rast se këto shpjegime janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë dhe të mos ketë vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese, dhe faktin nëse pasqyra financiare paraqet drejt transaksionet dhe ngjarjet bazë, në mënyrë që të arrihet paraqitja e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç çështjeve të tjera, edhe objektin dhe afatet e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne identifikojmë gjatë auditimit.

[Nënshkrimi në emër të firmës së auditimit, në emrin personal të audituesit ose të dyja bashkë, cilado është më e përshtatshme në juridiksionin e caktuar]

[Adresa e Audituesit] [Vendi dhe data dhe adresa]

[Data]

³⁶ Kjo fjali do të modifikohet, sipas rastit, në rrethanat kur audituesi së bashku me auditimin e pasqyrave financiare, ka edhe përgjegjësinë për të lëshuar një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

Ilustrimi 2: Një raport i audituesit mbi një pasqyrë financiare të një entiteti që nuk është një entitet i listuar, të përgatitur në përputhje me një kuadër për qëllime të veçanta

Për qëllime të këtij raporti të audituesit, ilustrues, supozohet se ekzistojnë rrethanat e mëposhtme:

- Auditimi i një pasqyre të arkëtimeve të marra dhe disbursimeve (pagesave) të bëra (d.m.th. një pasqyrë financiare e vetme) të një entiteti që nuk është një entitet i listuar.
- Nuk është lëshuar një raport i audituesit për paketën e plotë të pasqyrave financiare.
- Pasqyrat financiare kanë qenë përgatitur nga drejtimi i entitetit në përputhje me bazën kontabël të arkëtim pagesave, për t’ju përgjigjur një kërkesë për informacionet lidhur me flukset e parasë të marra nga një kreditor. Drejtimi ka një mundësi zgjedhje të kuadrove të raportimit financiar.
- Kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar është një kuadër i paraqitjes së drejtë, i hartuar për të plotësuar nevojat për informacion financiar të përdoruesve specifike.³⁷
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguar, audituesi ka arritur në përfundimin se duhet të jepet një opinion i pamodifikuar (d.m.th., “i pastër”).
- Audituesi ka përcaktuar se, është e përshtatshme që në opinionin e audituesit, të përdoret shprehja “paraqet drejt, në të gjitha aspektet materiale”.
- Kërkesat përkatëse etike që zbatohen për auditimin janë ato të juridiksionit.
- Shpërndarja ose përdorimi i raportit të audituesit nuk është i kufizuar.
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguar, audituesi ka arritur në përfundimin se nuk ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e entitetit për të vazhduar veprimarinë në vijimësi, në përputhje me SNA 570 (i rishikuar).
- Audituesit nuk i kërkohet, dhe përndryshe, ai nuk ka vendosur të komunikojë çështjet kryesore të auditimit në pajtim me SNA 701 në kontekstin e auditimit të pasqyrës së arkëtimeve dhe pagesave.

³⁷ SNA 800 (i rishikuar) përmban kërkesa dhe udhëzime për formën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare të përgatitura në përputhje me një kuadër për qëllime të veçanta.

- **Audituesi ka përcaktuar se nuk ka informacion tjetër (d.m.th., kërkesat e SNA 720 (i rishikuar) nuk zbatohen).**
- **Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrës financiare dhe mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar për përgatitjen e kësaj pasqyre financiare.**
- **Audituesi nuk ka përgjegjësi të tjera për të raportuar, të kërkuara nga legjislacioni ose rregullat lokale.**

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

[Marrësi i Përshtatshëm]

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrën e arkëtimeve dhe pagesave të Shoqërisë ABC (Shoqëria) për vitin që mbyllet në 31 Dhjetor 20X1, dhe shënimet e pasqyrës së arkëtimeve dhe pagesave, përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël (së bashku “pasqyrën financiare”).

Sipas opinionit tonë, pasqyra financiare bashkëlidhur paraqet drejt, në të gjitha aspektet materiale, arkëtimet dhe pagesat e Shoqërisë për vitin që mbyllet në 31 Dhjetor, 20X1 në përputhje me bazën kontabël të arkëtimeve dhe pagesave të përshkruar në Shënimin X. [Seksioni i Opinionit është vendosur në fillim siç kërkohet nga SNA 700 (i rishikuar)]

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrën Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrës financiare në [juridiksion], dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. [Fjalitë e para dhe të fundit në këtë seksion kanë qënë në pjesën e Përgjegjësive të Audituesit. Gjithashtu, seksioni Baza për Opinionin është vendosur menjëherë pas seksionit të Opinionit siç kërkohet në SNA 700 (i rishikuar).]

Theksimi i Çështjes – Baza Kontabël

Ne tërheqim vëmendjen në shënimin X të pasqyrave financiare, ku përshkruhet baza kontabël. Pasqyra financiare është hartuar për të dhënë informacione për Kreditorin XYZ. Si rezultat, pasqyra financiare mund të mos jetë e përshtatshme për qëllime të tjera. Opinioni ynë në lidhje me këtë çështje nuk është i modifikuar.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në Lidhje me Pasqyrat Financiare³⁸

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrës financiare në përputhje me kërkesat e bazës kontabël të arkëtim pagesave, të përshkruar në Shënimin X; dhe për kontrollin e brendshme që drejtimi i vlerëson të domosdoshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrës financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo të gabimit.

Për përgatitjen e pasqyrës financiare, drejtimi ka përgjegjësinë të vlerësojë aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar veprimtarinë në vijimësi, duke dhënë informacione shpjeguese, nëse është rasti, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe për përdorimin e bazës kontabël të vijimësisë, përveç rastit kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, apo nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrës Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë sigurinë e arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyra financiare në tërësi nuk ka anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve, gjithnjë do të identifikojë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, ato pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra mbi bazën e kësaj pasqyre financiare.

Paragrafi 41(b) i SNA 700 (i rishikuar) shpjegon se materiali i hijëzuar më poshtë mund të vendoset në një Shtojcë të raportit të audituesit. Paragrafi 41(c) i SNA 700 (i rishikuar) shpjegon se referimi mund të bëhet tek faja e internetit e një autoriteti të përshtatshëm, i cili përmban përgjegjësitë e audituesit, kur ligji, rregullat ose standardet kombëtare të auditimit e lejojnë shprehimisht, në vend të përfshirjes së këtij materiali në raportin e audituesit, duke u siguruar që përshkrimi në faqen e internetit trajton, dhe nuk është në kundërshtim me, përshkrimin e përgjegjësive të audituesit si më poshtë.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticismin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrës financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe sigurojmë evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të patur një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se rreziku që rrjedh nga gabimi, sepse

³⁸ Ose terma të tjerë që janë të përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor në juridiksionin e veçantë.

mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrollit të brendshëm.

- Sigurojmë një njohje dhe kuptim të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.³⁹
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit nga drejtimi të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të siguar, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar veprimtarinë në vijimësi. Nëse ne arrijmë në përfundimin se ka një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit, për informacionet shpjeguese të dhëna në pasqyrën financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë dhe të mos ketë vijimësi.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të bëra, nëse ka të tilla, dhe të informacioneve shpjeguese përkatëse të dhëna nga drejtimi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrës financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyra financiare paraqet transaksionet dhe ngjarjet bazë, në mënyrë që të arrihet paraqitjen e drejtë e tyre.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç çështjeve të tjerave, edhe për objektin dhe afatet e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne identifikojmë gjatë auditimit.

[Nënshkrimi në emër të firmës së auditimit, në emrin personal të audituesit ose të dyja bashkë, cilado është e përshtatshme në juridiksionin e caktuar]

[Adresa e Audituesit] [Vendi dhe data dhe adresa]

[Data]

³⁹ Kjo fjali do të modifikohet, sipas rastit, në rrethanat kur audituesi, së bashku me auditimin e pasqyrave financiare ka gjithashtu, përgjegjësinë për të lëshuar një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

Ilustrimi 3: Një raport i audituesit mbi një element të veçantë të një pasqyre financiare të një entiteti të listuar të përgatitur në përputhje me një kuadër për qëllime të veçanta.

Për qëllime të këtij raporti të audituesit, ilustrues, supozohen se ekzistojnë rrethanat e mëposhtme:

- Auditimi i një table të llogarive të arkëtueshme (që është, element, llogari ose zë i një pasqyre financiare).
- Informacioni financiar është përgatitur nga drejtimi i entitetit në përputhje me kërkesat e dispozitave të raportimit financiar të vendosura nga një rregullator për të përmbushur kërkesat e këtij rregullatori. Drejtimi nuk ka mundësi zgjedhje për sa i përket kuadrove të raportimit financiar.
- Kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar është hartuar për të plotësuar nevojat për informacion financiar të përdoruesve të veçantë.⁴⁰
- Kushtet e angazhimit të auditimit reflektojnë përshkrimin e përgjegjësisë së drejtimit për pasqyrat financiare sipas SNA 210.
- Audituesi ka arritur në përfundimin se bazuar në evidencën e auditimit të siguruar është i përshtatshëm të jepet një opinion i pamodifikuar (d.m.th., “i pastër”).
- Kërkesat përkatëse etike që zbatohen për auditimin janë ato të juridiksionit.
- Shpërndarja e raportit të audituesit është e kufizuar.
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, audituesi ka arritur në përfundimin se nuk ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e entitetit për të vazhduar veprimtarinë në vijimësi në përputhje me SNA 570 (i rishikuar).
- Audituesit nuk i kërkohet, dhe përndryshe, ai nuk ka vendosur të komunikojë çështjet kryesore të auditimit në pajtim me SNA 701 në kontekstin e auditimit të tabelës së llogarive të pagueshme.
- Audituesi ka përcaktuar se nuk ka informacion tjetër (d.m.th., kërkesat e SNA 720 (i rishikuar) nuk zbatohen).
- Personat që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e pasqyrës financiare ndryshojnë nga ata që janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrës financiare.
- Audituesi nuk ka përgjegjësi të tjera për të raportuar, të kërkuara nga legjislacioni ose rregullat lokale.

⁴⁰ SNA 800 (i rishikuar) përmban kërkesa dhe udhëzime mbi formën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare të përgatitura në pajtim me një kuadër për qëllime të veçanta.

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

[Për Aksionarët e Shoqërisë Tregtare ABC ose një Marrës Tjetër i Përshtatshëm]

Opinionit

Ne kemi audituar tabelën e llogarive të arkëtueshme të Shoqërisë ABC (Shoqëria) të datës 31 Dhjetor 20X1, (“tabela”).

Sipas opinionit tonë, informacioni financiar në tabelën e Shoqërisë më datën 31 Dhjetor 20X1, është përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me [përshkruaj dispozitat e raportimit financiar të vendosura nga rregullatori]. [Seksioni i opinionit është vendosur në fillim siç kërkohet nga SNA 700 (i rishikuar)]

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Tabelës*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në [juridiksionin], dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. Fjalitë e para dhe të fundit në këtë seksion kanë qënë në pjesën e Përgjegjësisive të Audituesit. Gjithashtu, seksioni Baza për Opinionin është vendosur menjëherë pas seksionit të Opinionit siç kërkohet në SNA 700 (i rishikuar).]

Theksimi i Çështjes – Baza Kontabël dhe Kufizimi në Shpërndarje

Ne tërheqim vëmendjen në Shënimin X të Tabelës, e cila përshkruan bazën kontabël. Tabela është përgatitur për të ndihmuar Shoqërinë për të plotësuar kërkesat e rregullatorit DEF. Si rezultat, tabela mund të mos jetë e përshtatshme për ndonjë qëllim tjetër. Raporti ynë është parashikuar vetëm për Shoqërinë dhe Rregullatorin DEF dhe nuk duhet t’ju shpërndahet palëve të tjera përveçse Shoqërisë ose Rregullatorit DEF. Opinionit ynë në lidhje me këtë çështje nuk është i modifikuar.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare ⁴¹

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e tabelës në përputhje me [përshkruaj dispozitat e raportimit financiar të vendosura nga rregullatori] dhe për kontrollet e brendshme që drejtimi i vlerëson të domosdoshme për të bërë të mundur përgatitjen e tabelës pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo të gabimit.

⁴¹ Ose terma të tjerë që janë të përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor në juridiksionin e veçantë

Për përgatitjen e tabelës, drejtimi ka përgjegjësinë për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar veprimtarinë në vijimësi, duke dhënë informacione shpjeguese, nëse është rasti për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe për përdorimin e bazës kontabël të vijimësisë, përveç rastit kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, apo nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Tabelës

Objektivat tona janë që të arrijmë sigurinë e arsyeshme lidhur me faktin nëse tabela në tërësi nuk ka anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve, gjithnjë do të identifikojë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali të mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, ato pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këtë tabelë.

Paragrafi 41(b) i SNA 700 (i rishikuar) shpjegon se materiali i hijëzuar më poshtë mund të vendoset në një Shtojcë të raportit të audituesit. Paragrafi 41(c) i SNA 700 (i rishikuar) shpjegon se referimi mund të bëhet tek faja e internetit e një autoriteti të përshtatshëm, i cili përmban përgjegjësitë e audituesit, kur ligji, rregullat ose standardet kombëtare të auditimit e lejojnë shprehimisht, në vend të përfshirjes së këtij materiali në raportin e audituesit, duke u siguruar që përshkrimi në faqen e internetit trajton, dhe nuk është në kundërshtim me, përshkrimin e përgjegjësive të audituesit si më poshtë.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të tabelës, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe sigurojmë evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të patur një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se rreziku që rrjedh nga gabimi, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë një njohje dhe kuptim të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të

përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.⁴²

- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit nga drejtimi të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të siguar, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar veprimtarinë në vijimësi. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit për informacionet shpjeguese të dhëna për tabelën, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë dhe të mos ketë vijimësi.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të bëra, nëse ka të tilla, dhe të informacioneve shpjeguese përkatëse të dhëna nga drejtimi.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç çështjeve të tjerave, edhe për objektin lidhur dhe afatet e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne identifikojmë gjatë auditimit.

Ne gjithashtu u japim personave të ngarkuar me qeverisjen, një deklaratë, ku shprehemi se kemi qenë në pajtim me kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë, dhe ju komunikojmë atyre të gjitha lidhjet dhe çështjet e tjera që në mënyrë të arsyeshme, mund të mendohet se ndikojnë në pavarësinë tonë, dhe kur është e zbatueshme, edhe masat mbrojtëse përkatëse.

Partneri i angazhimit të auditimit që rezulton në këtë raport të audituesit të pavarur është [emri].

[Nënshkrimi në emër të firmës së auditimit, në emrin personal të audituesit ose të dyja bashkë, cilado që është e përshtatshme në juridiksionin e caktuar]

[Adresa e Audituesit] [Vendi, data dhe adresa]

[Data]

⁴² Kjo fjali duhet të modifikohet, si të jetë e përshtatshme, në rrethanat kur audituesi ka gjithashtu përgjegjësinë për të lëshuar një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm së bashku me auditimin e tabelës.